

Çka janë depozitat?

**Cilat janë përparësitë e deponimit
të parave në bankë?**




Çka quajmë “depozitë”?

Depozitë është një term financiar që nënkupton paratë e mbajtura në një bankë.

Depozitat bankare janë një produkt kursimi që klientët mund ta përdorin për të ruajtur një shumë parash në një bankë për një kohë të caktuar.

Në këmbim, banka do t'i paguajë klientit një shumë të caktuar të interesit, sipas marrëveshjes, por edhe ju paguani një tarifë të caktuar për mirëmbajten e llogarisë.



Çka nënkuptojmë me llogari depozitimi / llogari kursimi?

-Llogari kursimi është një llogari depozite me interes, e mbajtur në një bankë.

-Depozitat dallohen në bazë të maturimit, qëllimit, vlerës minimale të deponimit dhe kushteve për tërheqjen e parave të deponuara.



Pse banka është opion më i mirë për kursime se çdo "variant shtëpie"?

-Ruajtja e parave në shtëpi është vetëm një ndarje fizike e një shume parash për të mos i shpenzuar, ndërsa deponimi i tyre në bankë ofron siguri e nëse i afatizojmë fitojmë edhe interes;



-Paratë në shtëpi i ekspozohen rreziqeve të papritura nga zjarri, përmbytja apo vjedhja.

-Rreziqeve të tilla, teorikisht u ekspozohen edhe bankat por gjasat janë pothuajse zero.



Kush garanton që depozitat tona në bankë janë të sigurta? Çfarë ndodh nëse mbyllet apo falimenton banka?

Edhe në rast të mbylljes apo falimentimit të bankës, paratë e depozitorëve janë të sigurta sepse këtë e garanton Fondi për sigurimin e Depozitave të Kosovës (FSDK), i themeluar me Ligjin mbi Sigurimin e Depozitave

<https://gzk.rks-gov.net/ActDocumentDetail.aspx?ActID=2725>.



Sa është limiti i sigurimit të depozitave?

Depozitorët janë të siguruar, për çdo bankë anëtare, deri në shumën e siguruar prej €5,000.

Shembull:

Një depozitor i siguruar që ka llogari në dy banka anëtare (psh. banka A dhe banka B) ka të siguruar depozitat e veta në ato dy banka, respektivisht në bankën A: deri në €5,000 dhe në bankën B: deri në €5,000.



A ka afat të caktuar për rimbursim?

FSDK pas revokimit të licencës dhe mbylljes së një banke, sa më shpejt që të jetë e mundur, do të fillojë dhe përfundojë rimbursimin e të gjitha kërkesave të verifikuara në mënyrë të rregullt, brenda 30 ditëve pas mbylljes së bankës.



Por çfarë ndodh nëse kërkesa e depozituesit tejkalon shumën prej €5,000?

Në atë rast, FSDK do të rimbursojë shumën deri në €5,000, ndërsa shuma e mbetur do t'i rimburohet nga likuidatori gjatë procesit të likuidimit të bankës.

Përveç sigurisë cilat janë përparësitë tjera të ruajtjes së kursimeve /depozitave në bankë?

Kursimi i parave në bankë njëkohësisht konsiderohet edhe meaxhim i shpenzimeve dhe ka përparësitë e saj:

-Bankat ju paguajnë interes sepse ju i ruani paratë tuaja tek ato, por edhe ju paguani një tarifë për mirëmbajten e llogarisë.

-Një nga përparësitë kryesore të kursimit të parave në një bankë në krahasim me kudo tjetër është se nëpërmes të "*historikut të transaksioneve*" ju keni mundësi të shikoni ku dhe sa keni shpenzuar apo kursyer paratë duke ju ndihmuar që në të ardhmen të reduktoni shpenzimet e panevojshme në favor të rritjes së shumës së kursimeve, që do t'ju motivoj edhe më shumë në kultivimin e shprehisë së kursimit.

-Pasi të ketë kaluar afati i rënë dakord, banka do t'ua kthejë shumën e depozituar plus interesat që janë grumbulluar gjatë asaj periudhe sipas normës së dakorduar.



Cilat janë llojet e depozitave bankare?

-Depozita me afat (afat fiks), nënkupton se pajtoheni që paratë tuaja t'i ruani në bankë për kohë të caktuar dhe mos t'i tërhiqni para afatit të maturimit.

Në këmbim, institucioni ju paguan interes të caktuar, bazuar në shumën që keni depozituar dhe afatin e rënë dakord.

-Depozitë me afat nuk do të thotë që ju nuk mund t'i tërheqni paratë nëse është e nevojshme, por nuk do të vlejë interesi për të cilin jeni dakorduar pasi që nuk i jeni përmbajtur afatit të përcaktuar në marrëveshje.



-Depozita pa afat (afat fleksibil) nënkupton se mund t'i tërhiqni paratë tuaja në çdo kohë.

Kjo lloj depozite u lejon klientëve të tërheqin të gjitha ose një pjesë të parave të tyre sa herë që u nevojiten, por norma e interesit tek depozitat pa afat në përgjithësi është shumë më e ulët se norma e interesit tek depozitat me afat.



Shikoni me kujdes Listën e Çmimeve në banka të ndryshme dhe krahasoni normat e interesit në depozita dhe kushtet që ofrojnë, dhe pastaj përzgjedheni bankën ku do t'i depozitoni kursimet tuaja.



Banka Qendrore e Republikës së Kosovës

Adresa: Rr. Garibaldi Nr.33,
Prishtinë, Kosovë

www.bqk-kos.org

E-mail: info@bqk-kos.org

Telefon: +383 38 222 055

Fax: +383 38 243 763